



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

---

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 6, nenit 7 paragrafët 3, 4 dhe 5 si dhe nenit 8 i Rregullores Nr. 04/2022, për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2023 të datës 23 Shkurt 2023, si dhe Vendimit DPSKPK /Nr. 417/2023 të datës 25 shtator 2023, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**KONKURS**  
**PËR REKRUTIMIN E NJËZETETETË (28) KANDIDATËVE PËR BASHKËPUNËTOR**  
**PROFESIONAL**

- Prokuroria e Apelit, tri (3) pozita
- Prokuroria Speciale, dy (2) pozita
- Prokuroria Themelore Prishtinë, tri (3) pozita
- Prokuroria Themelore Prizren, tri (3) pozita
- Prokuroria Themelore Pejë, katër (4) pozita
- Prokuroria Themelore Mitrovicë, tri (3) pozita
- Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë
- Prokuroria Themelore Gjakovë, dy (2) pozita
- Prokuroria Themelore Ferizaj, shtatë (7) pozita

**Detyrat Dhe Përgjegjësitë**

1. Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
2. Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin e lëndës detyrën dhe aktet e specializuara për miratim,
4. Mbështetë prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre;
5. Merr pjesë në cilësinë e ekspertit në seanca dëgjimore dhe në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
6. Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;

7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të institucionit;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arësyeshme kohë pas kohe.

### **Kriteret e Përgjithshme**

Kandidatët për Bashkëpunëtor Profesional në sistemin prokurorial duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Të kenë të kryer Provimin e Jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- Të kenë së paku një vit (1) përvojë pune profesionale për pozitat që shpallen në prokuroritë Themelore;
- Të kenë së paku dy vite (2) vite përvojë pune profesionale për pozitat që shpallen në Prokurorinë Speciale;
- Të kenë së paku tri vite (3) vite përvojë pune profesionale për pozitat që shpallen në Prokurorinë e Apelit dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Përveç kriterëve të përgjithshme si kritere plotësuese për vlerësimin e kandidatëve parashihen:

- Të kenë njohuri për sistemin prokurorial;
- Të kenë njohuri profesionale në fushën e legjislacionit në fuqi;
- Të kenë njohuri analitike të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;
- Të kenë njohuri për hulumtime ligjore;
- Të kenë njohuri kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel, etj).

### **Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara<sup>1</sup>;
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën e Provimit të Jurisprudencës, të pranuar sipas Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike, të përcaktuar me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
- Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata.

---

<sup>1</sup> Kandidatet të cilët aplikojnë për bashkëpunëtor profesional duhet të plotësojnë formularin të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkangjitur dokumentet e kërkuara me konkurs.

Kandidatët mund të dorëzojnë edhe dokumentacionet si në vijim:

- Publikime profesionale apo akademike, dhe/ose
- Informata për pjesëmarrje në trajnime.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data **29.09.2023 deri me datë 13.10.2023** si datë e mbylljes së konkursit.

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatit të Këshillit në formë fizike, përmes postës ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Kosovë si dhe përmes postes elektronike: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org).

Aplikimi përmes postës: Aplikacionet e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, prej orës 08:00 – 16:00.

Vetëm kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit dhe që i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet sipas konkursit kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kritereve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.